

**AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQËRISË “DESSARK” SH.P.K.**

Sot më datë 18 Janar 2022, **Znj. Fjorilda Muço**, e bija e Yllit, e datëlindjes 27.02.1994, lindur në Mbrakull, Berat shpreh vullnetin për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “**DESSARK**” sh.p.k. si më poshtë vijon:

**1. Forma ligjore e shoqërisë**

Shoqëria “**DESSARK**” sh.p.k., nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar”, shkurtimisht SHPK.

**2. Ortakët themelues**

Shoqëria është themeluar nga Ortaku i Vetëm **Znj. Fjorilda Muço**.

**3. Objekti i veprimtarisë**

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “**DESSARK**” sh.p.k. do të jetë:

Studim, projektim, mbikqyrje, kolaudim për ndërtim e zbatim, ndërtim të veprave ndërtimore të të gjitha llojeve sipas legjislacionit shqiptar. Studime urbanistike të të gjitha niveleve; planifikim urban; projektim arkitektonik; projektim strukturash mbajtëse beton-arme, metalike; projektim rrugësh, autostradash, aeroportesh,; vlerësime mjedisore; projektim linjash dhe sistemesh të prodhimit dhe shpërndarjes së energjise elektrike; projektim ujësjelles, kanalizime, vepra ujitje, kullimi, impiante vaditëse, diga, dampa, etj; projektim vepra naftësjelles, gazsjellës, etj; konsulenca ligjore dhe teknike në fushen e planifikimit të territorit; shitje- blerje pasurie të paluajtshme dhe cdo aktivitet tjeter që është fitimprurës për shoqërinë;

**4. Selia e shoqërisë**

4.1 Selia e Shoqërisë “**DESSARK**” sh.p.k. do të jetë në Tiranë, në adresën: Rruga e Elbasanit, Pallati EdilAI, Kati 2, Zyra nr 211.

4.2 Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

## **5. Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

## **6. Kapitali i shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “DESSARK” sh.p.k. është 500,000 Lekë.

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortaku i Vetëm themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontributet në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themelor të Shoqërisë bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të Shoqërisë në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt notarial.

## **7. Drejtimi dhe Administrimi**

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë “DESSARK” sh.p.k. është Znj. Fjorilda Muço.

Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “DESSARK” sh.p.k. në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njeh ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatë në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

## **8. Shpërbërja dhe likuidimi**

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkaku ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

**Ortaku i Vetëm**

Fjorilda Muço

Fjorilda Muço

FM  
Muço